

“RIKU” ofron shërbime për të gjitha viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore dhe të formave të tjera të shfrytëzimit për punë

A keni përjetuar ju personalisht ose një i afërmi juaj ndonjë nga sa vijon?

- A ka ndonjë person që ju ushtron presion për të bërë diçka të jashtëligjshme ose diçka tjetër që nuk dëshironi ta bëni?
- A ka ndonjë person (për shembull bashkëshorti, një i afërm, punëdhënësi) që kontrollon veprimet tuaja apo komunikimin tuaj me të tjerët?
- A ju kanë thënë se i keni para borxh dikujt për ardhjen tuaj në Finlandë ose a e keni paguar tashmë dikë për këtë?
- A ju kanë thënë se do të deportoheni ose do të humbisni lejen e qëndrimit nëse nuk bindeni?
- A po ju kërcënon dikush se do të shpërndajë informacionet tuaja personale?
- A keni frikë se, për shembull, punëdhënësi ose bashkëshorti juaj do t'ju lëndojë ju ose

të afërmit tuaj nëse nuk bini dakord me të apo nëse lini punën apo i jepni fund marrëdhënies?

- A ju kanë mashtruar në lidhje me punën që erdhët të bëni apo rrethana të tjera?
- A ju kanë premtuar pagë më të lartë se ajo që merrni në të vërtetë?
- A punoni rregullisht më shumë se pesë ditë në javë ose më shumë se 8 orë në ditë pa pagesë shtesë?
- A ka marrë dikush borxhe në emrin tuaj apo ju ka detyruar të nënshkruani dokumente që nuk i kuptoni?
- A përdoret llogaria juaj bankare ose a kontrollohen financat tuaja nga një person tjetër?

Nëse i jeni përgjigjur me “po” njëres ose shumë prej këtyre pyetjeve, ju lutemi kontaktoni help@riku.fi në çfarëdo gjuhe ose kontaktoni në një nga numrat e dhënë në riku.fi/trafficking.



040 632 9293

RIKU

RIKOSUHRIPÄIVYSTYS
BROTTSOFFERJOUREN

Mbështetja për Viktimat në Finlandë (RIKU)
udhëzon dhe mbështet viktimat e krimit, të afërmit e tyre dhe dëshmitarët e krimit.



NË INTERNET



ME TELEFON



BALLË PËR
BALLË

Na kontaktoni nëse:

- jeni viktimë e një krimi
- jeni dëshmitar i një krimi
- një i afërmi juaj është viktimë e një krimi
- dyshoni se jeni viktimë e një krimi dhe dëshironi të diskutoni përvojat tuaja dhe/ose të merrni këshilla praktike

Shërbimet tona janë plotësisht konfidenciale. Mund të na kontaktoni me telefon ose në internet – edhe në mënyrë anonime. Po ashtu, mund të kërkonte takim ballë për ballë pranë një prej zyrave tona. Ne nuk i japim askujt informacion rreth rastit tuaj pa marrë miratim nga ju.



NË INTERNET



Në faqen e internetit “**Riku.fi**” jepen informacione në gjuhë të ndryshme në lidhje me “RIKU” dhe proceset penale.



Dërgoni një email në **help@riku.fi** për të marrë mbështetje dhe këshilla, nëse dyshoni për trafikim të qenieve njerëzore apo shfrytëzim për punë. Mund të na shkruani në gjuhën tuaj amtare.



“**RIKUchat**” është një shërbim në kohë reale që ofrohet kryesisht në finlandisht: **riku.fi**



ME TELEFON

LINJA KOMBËTARE E NDIHMËS 116 006

E hënë–E premte, ora 9:00–20:00 (kryesisht në finlandisht)

Linja e ndihmës juridike 0800 161 177

E hënë–E enjte, ora 17:00–19:00 (në finlandisht)



BALLË PËR BALLË



Zyrat e “RIKU” anembanë Finlandës ofrojnë mbështetje falas. Ne mund të përdorim një interpretues që ka detyrimin të respektojë me rigorozitet ruajtjen e konfidencialitetit. Të dhënat e kontaktit gjenden në adresën “**riku.fi**”.



Mund të kërkonte gjithashtu një person mbështetës, i cili mund t’ju takojë, të diskutojë me ju dhe t’ju ofrojë këshilla praktike. Ai mund t’ju shoqërojë edhe në rajonin e policisë ose në gjykatë.

“RIKU” është një organizatë joqeveritare (OJQ) pa përkatësi politike ose fetare.

